REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

Nr.1924 Regj. Them. **Korçë, me datë 15.05.2026**

NJOFTIM

ME SHPALLJE PUBLIKE PËR NJOFTIMIN E PADISË, AKTEVE BASHKËLIDHUR SAJ SI DHE TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE LIGJORE

(Në këndin e shpalljeve)

DREJTUAR: Njesia Administrative Pojan

Për të paditurin: Bujar Qerim: Rr."Devollinjte", Nd.9, H.1, 7014, Njesia Administrative Pojan, Maliq.

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është duke u zhvilluar gjykimi i çështjes civile me Nr. 1924 regj. them. që u përket palëve ndërgjyqëse.

PADITËS:	Muharem Qerim .
I PADITUR:	Bujar Qerim etj...
OBJEKTI:	Pjestim pasurie
BAZA LIGJORE:	Neni 207 e vijues i K.Pr.Civile.

BASHKIA MA 2
Zyra e Protokollit
Nr.3049 Prot
Date 20.5.26 Nënshkrimi

Meqënëse shtetasi **Bujar Selajdin Qerim,** i paditur në këtë gjykim nuk ndodhet në adresën e vendbanimit të tij, gjykata konform neneve 133/a dhe 133/b të K.Pr.Civile vendosi ta njoftojë me shpallje, e cila zë vendin e komunikimit.

I padituri, **shtetasi Bujar Selajdin Qerim** duhet të paraqitet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për të marrë kërkesë padinë dhe aktet bashkëlidhur saj, si edhe një kopje të njoftimit të të drejtave dhe detyrimeve ligjore. Ai ka të drejtën e paraqitjes së **deklaratës së mbrojtjes jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi.**

Njoftimi me shpallje përpilohet në 4 kopje. Një kopje afishohet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ku do të gjykohet mosmarrëveshja, një kopje në këndin e afishimit të Njësisë Administrative përkatëse, një kopje në vendbanimin e fundit të të paditurit dhe një kopje në dosje.

Njoftimi të botohet edhe në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës, dhe/ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim.

Mosparaqitja e të paditurit për marrjen e akteve objekt njoftimi brenda afatit të përcaktuar nga gjykata, passjell konsiderimin të njoftuar të akteve objekt njoftimi.

Njesia Administrative përkatese duhet të përcjellë në gjykatë një konfirmim mbi afishimin e shpalljes dhe datën e afishimit të saj.

GJYQTARE
Gentiana SHUKULLARI

Shpallja u afishua sot në datë _____
Për Gjykatën/Bashkinë/Vendbanimin _____
(emër, mbiemër, nënshkrimi)

- Pj. A. Pojan
- ST MP
dt 20.05.26